

# BULETINI 3 - MUJOR

JANAR - MARS  
2025

**Kredia e Butë dhe Garancia Sovrane janë dy instrumente të rëndësishme që lehtësojnë aksesin në financim për sektorin e bujqësisë. Me një linjë financimi prej 250 milionë eurosh dhe një normë interesi prej 3.5% për Kredinë e Butë, ky mekanizëm, i kombinuar me Garancinë Sovrane, ul normën e interesit në 2% dhe mbulon deri në 70% të kolateralit.**

## TAKIME INFORMUESE MBI KREDINË E BUTE DHE GARANCINË SOVRANE



Në kuadër të prezantimit të instrumenteve të Kredisë së Butë dhe Garancisë Sovrane, MBZHR dhe AZHBR, në bashkëpunim me përfaqësues të bankave të nivelit të dytë, zhvilluan shtatë takime konsultuese me pjesëmarrjen aktive të rreth 150 përfaqësuesve nga sektorë të ndryshëm të bujqësisë dhe agrobiznesit.



Gjatë këtyre takimeve, me përfshirjen e përfaqësuesve të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Shoqatës së Agroturizmit Shqiptar, Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë, Shoqatës së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, si edhe subjekteve të tjera aktive në sektorin bujqësor, u diskutua mbi kriteret dhe sektorët që do të mbështeten.



Këto dy instrumente synojnë të lehtësojnë aksesin në financim për sektorët prioritarë: prodhimin bujqësor dhe blegtoral, mekanizimin dhe inovacionin, agropërpunimin dhe infrastrukturën agroturistike.



## BASHKËPUNIM DHE SHKËMBIM EKSPERIENCASH



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES AZHBR DHE AGJENCISË HOMOLOGE KROATE

AZHBR dhe Agjencia Homologe Kroate nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në Zagreb, Kroaci, e cila synon shkëmbimin e informacionit, eksperiencës dhe metodave të përdorura në zhvillimin e sistemeve operacionale për zbatimin e fondeve të Bashkimit Evropian. Marrëveshja parashikon organizimin e përbashkët të konferencave, seminareve dhe trajnimeve për menaxhimin e fondeve, pagesat direkte, zhvillimin rural dhe masat e tregut.

## VIZITË STUDIMORE PRANË AGJENCISË HOMOLOGE KROATE

Stafi i MBZHR dhe AZHBR, kryesuar nga Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Ardita Kuçi, zhvilloi një vizitë studimore pranë Agjencisë Homologe në Zagreb. Vizita studimore, mbështetur nga GIZ, pati për qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi sistemet për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të parcelave bujqësore (LPIS dhe ARKOD). Delegacioni shqiptar u njoh me funksionimin e sistemeve të menaxhimit të pagesave (IACS) dhe monitorimit të aktivitetit bujqësor (AMS), duke marrë pjesë në disa trajnime praktike në zyrat qendrore dhe rajonale të PAAFRD.



## TAKIMI I DREJTORESHËS SË PËRGJITHSHME TË AZHBR ME DELEGACIONIN E AGJENCISË IPARD TË TURQISË

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR, znj. Ardita Kuçi, mirëpriti në takim një delegacion nga Agjencia IPARD e Turqisë, i përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë. Fokusi i takimit ishte shkëmbimi i eksperiencave mbi menaxhimin e investimeve dhe përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për zhvillimin bujqësor dhe rural.

Diskutimet u përqendruan në strukturat e menaxhimit, metodat e zbatimit dhe kontrollet e brendshme, që janë të rëndësishme për të siguruar transparencën dhe efikasitetin e projekteve. Ky takim forcon më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin mes dy institucioneve.



## TRAJNIME



### TRAJNIM MBI IDENTIFIKIMIN E PARREGULLSIVE NË ZBATIMIN E PROGRAMIT IPARD

Stafi i AZHBR mori pjesë në një cikël trajnimesh me synim identifikimin dhe parandalimin e parregullsive të mundshme gjatë implementimit të programit IPARD III. Trajnimet u udhëhoqën nga ekspertë ndërkombëtarë, me mbështetjen teknike dhe ekspertizën e ofruar nga Programi TAIEX i Bashkimit Evropian, me fokus përmbushjen e standardeve të BE-së. Ky bashkëpunim synon përmirësimin e procedurave dhe forcimin e sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe auditimit të parregullsive.



### TRAJNIM PËR PËRGATITJEN DHE AVANCIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SISTEMET IT TË AZHBR

AZHBR përmbylli me sukses ciklin e trajnimeve me fokus përgatitjen dhe auditimin e sistemeve IT të avancuara të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve dhe të dhënave, me qëllim përmirësimin e kuadrit të auditimit të brendshëm. Ky trajnim, i mbështetur nga TAIEX dhe i realizuar me ekspertë të agjencive homologe nga Rumania, Kroacia dhe Polonia, synoi përgatitjen e stafit të auditimit për të realizuar auditime të brendshme të sistemeve të IT, duke vlerësuar risqet dhe masat kontrolluese përkatëse.



### STATISTIKA TË SKEMËS KOMBËTARE 2024

Skema Kombëtare e Subvencioneve 2024 mbështeti 67,133 fermerë përmes 8 masave, ku 52,195 fermerë përfituan mbështetje me naftë. Qarku i Fierit kryeson me numrin më të lartë të përfituesve, pasuar nga Qarku i Korçës, duke theksuar traditën bujqësore dhe angazhimin për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit në këto zona. Pagesat u realizuan në masën 100%, për të gjitha masat mbështetëse, me një fond total prej 5.2 miliardë lekësh.


Skema Kombëtare e subvencioneve në bujqësi ka për synim uljen e kostove për fermerët dhe rritjen e rendimentit për prodhimin vendas.



## SKEMA KOMBËTARE E INVESTIMEVE 2024

Skema Kombëtare e Investimeve ka regjistruar gjithsej 404 aplikime, nga të cilat 360 kanë përmbushur kriteret e përzgjedhjes dhe 280 aplikime janë shpallur të kualifikuara. Procesi i nënshkrimit të kontratave me përfituesit vijon, ndërsa deri tani janë lidhur 177 kontrata.

Kjo skemë mbështet fermerët përmes pesë masave: ndërtimi i serrave të reja diellore, instalimi i rrjetave antibreshër, ndërtimi i stallave, mekanizimi i bujqësisë dhe mbështetje për akuakulturën detare.



## MIRATOHET SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES NË BUIQËSI 2025

Skema Kombëtare e Subvencioneve 2025, do të vijojë në mbështetje të fermerëve në të gjithë vendin, përmes tetë masave mbështetëse.

Risi e këtij viti është mbështetja me 5000 lekë për krerë viçash për majmëri, për jo më pak se 10 krerë, dhe mbulimi deri në 50 % të faturës tatimore për kontrollin biologjik të dëmtuesve në serra, duke siguruar më shumë mbështetje për të gjithë fermerët të cilët plotësojnë kriteret.



## DREJTORESHA E AZHBR NË INTERVISTË PËR ABC NEWS MBI INSTRUMENTET MBËSHTETËS PËR FERMERËT

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR, znj. Ardita Kuçi, në intervistën e dhënë për ABC News, prezantoi garancinë sovranë dhe kredinë e butë, dy instrumente që do të lehtësojnë aksesin në financë për sektorin e bujqësisë.

Gjithashtu, u prezantua Skema Kombëtare e Subvencioneve për vitin 2025 dhe masat mbështetëse sipas VKM-së së miratuar.